# DËSHMI ARKIVI

**A-462575**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kurti pas takimit me kryeministrin e Kroacisë: Aktgjykimi i Speciales është i pasaktë, i padrejtë dhe i rënd ë - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/kurti-pas-takimit-me-kryeministrin-e-kroacise-aktgjykimi-i-speciales-eshte-i-pasakte-i-padrejte-dhe-i-rende/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:49:02 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 22 shtator 2026, 18:02:42 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `73871c3e13492d495ae022be37d591504815c390a0623f1f4288f95490de0e5f` |
| TEKSTI | `3578856b92de705ae885ee1e59ff25ad54bf4907435bef680e6a5c743886218b` |
| PAMJA | `ac1cdf3e929471378b7aa2c2bb7f23890a59ba88bcb1a1a84077f53c2b810b1e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a6f62faa8dc35e70a1ab7f5b64fcea297e1ee352f12148812e9542928cc91f7d` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a6f62faa8dc35e70a1ab7f5b64fcea297e1ee352f12148812e9542928cc91f7d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVË | RAJONI

# Kurti pas takimit me kryeministrin e Kroacisë: Aktgjykimi i Speciales është i pasaktë, i padrejtë dhe i rëndë

22 Shtator 2026 | 20:02

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti përmes një postimi në "Facebook" ka ndarë detaje lidhur me takimin e tij të zhvilluar në New York me homologun e Kroacisë, Andrej Plenkoviq. Kurti e cilësoi Kroacinë si vend partner dhe mik të Kosovës.

Ndër bisedat, Kurti theksoi se foli edhe lidhur me luftërat që kanë përjetuar dy vendet nga Serbia. Ai shkruan se Kosova dhe Kroacia janë dy vende që kanë luftuar për çlirim dhe pavarësi nga regjimi i Slobodan Milloshevicit. Lidhur me vendimin e Gjykatës Speciale të Hagës, Kurti u shpreh se është i padrejtë, i pasaktë dhe i rëndë.

"Sot ditën e nisëm me takimin me kryeministrin e Kroacisë, Andrej Plenkoviq, shtetit partner të Republikës dhe popullit mik të Kosovës.

Krahas sigurisë dhe mbrojtjes, fusha në të cilat veçse kemi bashkëpunim të shkëlqyeshëm, synojmë thellimin e marrëdhënieve ekonomike e tregtare. Gjatë këtij viti, Kosova shënoi rritje ekonomike prej 5.4% në tremujorin e parë dhe 4.1% në tremujorin e dytë. Përveçse rritje të qëndrueshme të ekonomisë, që këtë vit pritet të tejkalojë në 12 miliardë euro nga 7 sish sa ishte në vitin e parë të qeverisjes sonë, kemi forcuar sundimin e ligjit sikurse kemi shënuar përparim demokratik.

Si dy vende që kanë luftuar për çlirim e pavarësi nga i njëjti regjim, si ai i Milloshevicit, dihet mirëfilli se kush ka kryer krime në katër luftërat në ish-Jugosllavi. Lufta e drejtë e popullit të Kosovës ka qenë e pastër dhe çlirimtare karshi regjimit gjenocidal të Serbisë. Prandaj, theksova se aktgjykimi i Dhomave të Specializuara, përveçse i pasaktë, është i padrejtë dhe i rëndë.

Krahas mohimit e fshehjes krimeve të kryera në Kosovë, Serbia vazhdon t'i mbajë të mbyllura dhe klasifikuara arkivat e saj, hapja e të cilave është thelbësore për zbardhjen e fatit të të zhdukurve me dhunë gjatë luftës, për të vërtetën dhe për drejtësinë. Në anën tjetër, fqinji verior, në mënyrë sistematike, vazhdon spastrimin etnik administrativ ndaj komunitetit shqiptar në Luginën e Preshevës nëpërmjet pasivizimit të adresave dhe

LAJMI I FUNDIT

20:28 Kapet në Rusi 'bosi' shqiptar i 'kartelit' te drogës Shpëtim Aliu

20:16 Administrata Trump po përgatit planin për ndalimin 90-ditor të eksporteve të naftës

20:11 Trump zbulon marrëveshje aksionesh me vlerë miliona dollarë në industrinë e teknologjisë dhe AI

20:05 Shtetet Baltike i kërkojnë BE-së 500 milionë euro për mbrojtjen kundër dronëve

19:51 Moska refuzon armëpushimin, Lavrov: Rusia nuk do t'i ndalë luftimet

19:37 E ardhmja e Merz në pikëpyetje, gati gjysma e votuesve kërkojnë zgjedhje të reja

TESTIM

përjashtimit nga institucionet.

Me Kroacinë kemi rritur bashkëpunimin ushtarak edhe në fushën e mbrojtjes, për çka shpreha vlerësimin tim në takim. Duke theksuar rëndësinë e anëtarësimit të Kosovës në Kartën e Adriatikut, falënderova Kroacinë për mbështetjen e vazhdueshme dhe të palëkundur në procesin e integrimit evropian dhe euroatlantik, si dhe në përballjen me sfidat e përbashkëta të sigurisë në rajon", shkruan ai.

**Shiko në:**


## LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | RAJONI

**Familjet Thaçi, Veseli e Krasniqi kërkojnë përgjegjësi institucionale: Presim të takohemi pas vendimit të Kuvendit**

Familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Jakup Krasniqit kanë bërë thirrje për përgjegjësi institucionale dhe unitet qytetar, në një kohë kur vendimi ndaj ish-krerëve...

18:58 | 23/09/2026

KOSOVË | RAJONI

**Kreu i AAK pas vendimit të Kushtetueses në Kosovë: Vendi shkon në zgjedhje**

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ardian Gjini, ka reaguar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila konstatoi se afatet për konstituimin e...

16:42 | 23/09/2026

KOSOVË | RAJONI

**Kushtetuesja: Kuvendi i Kosovës është konstituar, formimi i Qeverisë s'është antikushtetues**

Gjykata Kushtetuese ka vendosur se konstituimi i Kuvendit dhe formimi i Qeverisë nuk janë antikushtetues. Gjithashtu, ka konstatuar se afati për zgjedhjen e presidentit është...

15:07 | 23/09/2026



**Follow Euronews on all platforms:**

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.